

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.53, date 29.1. 2004

**PER PROCEDURAT DHE MASEN E TRAJTIMIT TE VECANTE FINANCIAR TE
PILOTEVE FLUTURUES, NE PENSION**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 3 e 8, te ligjit nr.9128, date 29.7.2003, "Per nje trajtim te vecante financiar te piloteve fluturues, ne pension", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes dhe te ministrit te Punes dhe te Ceshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi i interesuar, per efekt te llogaritjes, caktimit dhe pageses se shteses mbi pension, si trajtim i vecante financiar, ne zbatim te ligjit nr.9128, date 29.7.2003, "Per nje trajtim te vecante financiar te piloteve fluturues, ne pension", te terheqe nga dega e sigurimeve shoqerore dy formulare kerkese per perfitim, te cilat t'i dorezoje ne repartin ku ka punuar deri ne nderprerjen e marredhenieve financiare apo ne komanden e Forcave Ajrore, kur reparti eshte suprimuar, dhe ne degen e sigurimeve shoqerore, ku ka vendbanimin.

Dokumentacioni i nevojshem per perfitimin e trajtimit te vecante te pergatitet nga repartet ushtarake dhe te dergohet ne Ministrine e Mbrojtjes, e cila, pasi e shqyrton, e dergon ate ne degjet perkatese te sigunmeve shoqerore.

2. Per llogaritjen e trajtimit financiar te merret si baze paga referuese, e cila perbehet nga paga baze per funksionin plus shperblimin per grade, te njesuar me pagen referuese te funksionit organik te ushtarakut aktiv, ne te njejten detyre me perfituesin, ne castin e lindjes te se drejtes per kete trajtim financiar.

- Paga baze per funksion perfshin:

- a. Pagen baze per klasen e funksionit organik;
- b. Shtesat per vjetersi;
- c. Shtesat per veshtiresi vendi e sherbimi.

- Paga referuese per perfituesin, te cilit e drejta i lind nga data 1 janar 2004, perfshin:

- a. Pagen baze per grade;
- b. Shtesen per natyre te vecante;
- c. Shtesen per demshmeri shendeti;
- c. Shtesen per ruajtje page.

3. Kur funksioni dhe grada e ushtarakut perfitues nuk ekzistojne, ministri i Mbrojtjes ben njesimin e tyre me funksionet dhe gradat aktuale.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqerore per hartimin e udhezuesit dhe te

dokumentacionit tip per zbatimin e ketij vendimi dhe per dhenien e pagave per shitesat mbi pension, sipas marreveshjes me agjentin pagues.

5. Efektet financiare, qe rrjedhin nga zbatimi i ketij vendimi, te cilat llogariten, per vitin 2003, ne shumen 7 500 000 (shtate milione e peseqind mije) leke dhe, per vitin 2004, ne shumen 23 000 000 (njezet e tre milione) leke, te perballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar per Institutin e Sigurimeve Shoqerore.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqerore per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrje ne fuqi te ligjit nr.9128, date 29.7.2003, "Per nje trajtim te vecante financiar te piloteve fluturues, ne pension".

**KRYEMINISTRI
FATOS NANO**

**MINISTRI I MBROJTJES
PANDELI MAJKO**

**MINISTRI I PUNES DHE I CESHTJEVE SOCIALE
ENGJELL BEJTAJ**